

5th European and inter-networks meetings Protection and attractiveness of ancient town centres



Raport

lidhur me pjesëmarrjen time në takimin e pestë Evropian me temë “Mbrotjtja dhe atraktiviteti i qendrave të vjetra të qyteteve”.

Organizator: Asociacioni Nacional i qyteteve dhe regjioneve të artit, historisë dhe qyteteve me zona të mbrojtura;
Ministria e kulturës e Republikës së Maqedonisë;
Asociacioni i qyteteve historike dhe artistike i Republikës së Maqedonisë;

Të përkrahur nga: Ministria Franceze e Punëve të Jashtme;
Ministria Franceze e Kulturës dhe Komunikimit;
Ambasada Franceze në Republikën e Maqedonisë;
Qendra Kulturore Franceze e Shkupit.

Pjesëmarrësit: Pjesëmarrja e konsiderueshme nga vende të ndryshme si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Franca, Kroacia, Rumania, Bullgaria, Spanja;

Vendi: Shkup, Republika e Maqedonisë,

Data: 25-26.11.2010



Qëllimi i takimit ishte që t'i bashkojë qytetet historike nga Maqedonia, Franca, Evropa Lindore në temën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe atë se si mund të ringjallen qendrat e qyteteve historike, bazuar në njohuri dhe praktika të vendeve me fizionomi të ndryshme.

Shkëmbimin e pikëpamjeve për atraktivitetin e qendrave historike të qyteteve, hapësirat në të cilat zhvillohet dhe të cilat kanë nevojë të revitalizohen: qendrën e qytetit e përbëjnë shtëpitë e banimit, objektet e trashëgimisë, shitoret dhe shërbimet tjera. Si mund të zhvillojmë një projekt të integruar që vepron në të gjitha këto sfera në mënyrë të balancuar? Cilat strategji duhet të zhvillohen, në mënyrë që qendrat e qyteteve të mbesin atraktive dhe të përziera?

Gjatë këtyre dy ditëve ka pas shumë prezantime dhe tema të shumta, për qytete të ndryshme Evropiane, të cilët varësisht nga pozita e tyre gjeografike, numri i banorëve, periudha e ndërtimit etj, janë ballafaquar me probleme dhe sfida të ndryshme. Gjetja e mënyrës për ngjalljen e qendrave historike dallohej për nga forma, por gjithnjë me qëllim të mbrojtjes dhe zhvillimit të këtyre zonave në kuadër të qytetit në tërësi.

“Strategjitë e revitalizimit të qendrave të qyteteve”

Është prezantuar rast i një qendre historike në një qytet të vogël francez. Iniciativat kanë qenë që të hartohet një plan për mbrojtje të qendrës, ku pastaj kanë bërë identifikimin dhe kategorizimin e objekteve varësisht nga rëndësia që kanë. Me një vizion që qendra të jetë në të ardhmen si shëtitore për të gjithë, pas definimit të nevojave të banorëve, llojit të shërbimeve dhe menaxhimit të qendrës me trashëgimi kulturore, janë bërë ndërrim destinimet e shtëpive në dyqane, restorante etj, është ndaluar qarkullimi i automjeteve, parkingjet janë paraparë jashtë qendrës dhe me elemente tjera përcjellëse, qendra ka filluar të gjallërohet që ishte edhe qëllim kryesor i tyre. E gjithë kjo është arritur me formën e subvencionimit dhe përkrahjen politike të qytetit.

“Funksionet e përziera të qendrave të qyteteve”

Qendrat historike në të kaluarën kanë pas funksion të banimit, funksion tregtar dhe të përzier. Varësisht se cilit lloj i takonin dhe me karakteristikat plotësuese që e identifikojnë qytetin, mundësohet gjallërimi i këtyre qendrave përmes zhvillimit të turizmit hotelier, artizanal, universitar, kulturor, eko-turizëm etj.

“Promovimi i qendrave të qyteteve përmes profesionit të artit”

Është prezantuar një rast shumë interesant për një qytet të vjetër francez. Gjallërimin e zonës historike të saj e kanë arritur duke promovuar jetën dhe veprimtarinë e dramaturgut të shquar Molierit, i cili është identifikuar si ikonë e atij vendi. Me përdorimin e elementeve përcjellëse audio-vizuale, kanë arritur që t'i tërheqin turistë të shumtë, pra kanë arritur që t'a zhvillojnë në aspektin ekonomik qendrën historike poashtu edhe qytetin në tërësi.

“Rehabilitimi urban: si çështje Evropiane. Qasja e Këshillit të Evropës”

Rehabilitimi i qendrave urbane arrihet me: Konservim të integruar; Zhvillim të qëndrueshëm; dhe Politika Urbane;

Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore, në kontekst të zhvillimit ekonomik duhet të jetë e lidhur ngushtë me planifikimin hapësinor dhe duhet të integrohet përmes aktiviteteve që dalin nga planet e caktuara.

“Mjetet e menaxhimit të qendrave historike të qyteteve”

Promovimi i artizanateve atraktive dhe komerciale;

Organizimi i manifestimeve kulturore;

Tabelat informuese;

Web. faqja e qytetit;

Fotografitë dhe reklamat e ndryshme;

Ofrimi i audio-ciceronëve për objekte me vlera të veçanta historike;

Organizimi i punëtorive me fëmijë të shkollave fillore, me anë të vizatimeve, maketave etj.

Informimi dhe promovimi i rëndësisë së zonës me anë të debateve me qytetarë;

Ofrimi i shërbimeve karakteristike dhe të veçanta për ato anë;

Pra, të gjitha këto që u cekën më lartë të japin ide dhe mundësi për zhvillim të këtyre qendrave historike të cilat çdo ditë e më shumë po "vdesin" dhe të cilave duhet gjetur mundësi që t'i jetësojmë, ti bëjmë më atraktive por edhe t'i mbrojmë njëkohësisht.

Nga ky takim dyditor, është arritur që të shkëmbehen idetë, strategjitë, studimet, metodat dhe përvojat nga vendet e ndryshme të cilat ballafaqohen me çështje dhe sfida të ndryshme, si dhe gjetjen e formave dhe mundësive për ringjallje, atraktivitet dhe mbrojtje të qendrave historike në disa vende të Rajonit, Ballkanit dhe më gjerë.

Çdo qendër historike duhet të ketë një **Plan urbanistik** (apo ndonjë plan tjetër), përmes së cilit do të kontrollohen zhvillimet dhe parashihet e ardhmja e saj;

Planit duhet në vete të përmbajë këto elemente:

Kufiri i qendrës historike

Inventarizimi – duhet të ekzistojnë të dhënat bazë për secilin objekt që përfshihet në zonë;

Shenjëzimi – të paraqiten shenjëzimet me mënyra të ndryshme, me të cilat do të arrihet informim për objektin dhe për qendrën në tërësi;

Infrastruktura – rregullimi i infrastrukturës duke i ruajtur elementet historike dhe përshtatur për kushtet e sotme;

Banimi – edhe banimi njëjtë si infrastruktura duhet revitalizuar, mbrojtur mirëpo edhe duhet përshtatur kushteve të sotme të jetesës, sepse kërkesat për banim dallojnë gjatë periudhave historike;

Peizazhi kulturor – element i rëndësishëm i cili duhet trajtuar në plane të tilla;

Është përmendur **Subvencionimi**, si formë shumë e rëndësishme e cila mund të ndihmojë për zgjidhje të së ardhmes dhe të fuqizojë mundësinë e atraktivitetit të një qendre historike.

Të gjitha këto përvoja nga ky takim janë të mundshme të aplikohen edhe te ne në Kosovë.

Ajo çka duhet të theksohet është se duhet të ekzistojë vullneti politik i nivelit qendror dhe atij lokal dhe së bashku me profesionistët nga kjo lëmi do t'a ngritin rëndësinë e mbrojtjes dhe atraktivitetit të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Me respekt

Festa Nixha-Nela

MMPH/Instituti për Planifikim Hapësinor